# DËSHMI ARKIVI

**A-442022**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Viti i ri shkollor/ Presidenti Begaj uron nxënësit: E ardhmja është në duart tuaja |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sociale/viti-i-ri-shkollor-presidenti-begaj-uron-nxenesit-e-ardhmja-eshte-ne-dua-i585915` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 06:23:05 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 06:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e2244b61fa8bde0d2b5e92b29744ac7b3d826525f2c676adfb9d3a049596b543` |
| TEKSTI | `17f738ffd35950e860dde3894bea013bb73699a180c6ee133c8f317a551b6e78` |
| PAMJA | `5dc3ca1ce3b65eba13bfd80f8fd47365570282148fa36f6da13e2a32ad62b25a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `74f70f8362e53219c9582267b0efb9bd8872c536f83a8020a928ddbb9fbc7571` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/74f70f8362e53219c9582267b0efb9bd8872c536f83a8020a928ddbb9fbc7571`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English



# Viti i ri shkollor/ Presidenti Begaj uron nxënësit: E ardhmja është në duart tuaja

14 Shtator 2026, 08:50Sociale TEMA



Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, uroi nisjen e vitit të ri shkollor. Në një mesazh të posaçëm, presidenti Begaj shprehet se çdo ditë e re në shkollë është një mundësi për të mësuar, për të zbuluar dhe për të ëndërruar.

Duke vlerësuar rëndësinë e shkollës në formësimin e brezave të rinj dhe arsimimin cilësor si themel për të ardhmen e vendit, Kreu i Shtetit motivon nxënësit të ndjekin më përkushtim këtë vit shkollor.

“Besoni te vetja, besoni tek ëndrrat tuaja dhe tek e ardhmja. Ajo do të jetë më e mirë dhe është në duart tuaja”, u shpreh presidenti Begaj në mesazhin e tij.

Presidenti Begaj përcolli një urim të veçantë për fëmijët që ulen për herë të parë në bankat e shkollës. Ai shprehu gjithashtu mirënjohje për të gjithë ata mësues, të cilët me përkushtim, durim dhe dashuri kryejnë këtë mision fisnik.

“*Sot nis viti i ri shkollor për mijëra nxënës në të gjithë vendin. Çdo vit, çdo ditë e re në shkollë është një mundësi për të mësuar, për të zbuluar, por edhe për të ëndërruar. Shkolla nuk është thjesht një vend ku marrim dije. Është vendi ku përgatitemi të marrim përgjegjësi, ku mësojmë të njohim botën, të njohim vendin tonë, të kuptojmë historinë e tij, të çmojmë kulturën dhe vlerat e të kuptojmë misionin që kemi për të ardhmen e tij.*

*Uroj të gjithë nxënësit, veçanërisht ata që ulen për herë të parë në bankat e shkollës, të kenë një vit të mbarë, të suksesshëm dhe të bukur! Një urim i veçantë për mësuesit, të cilët me përkushtim, durim dhe dashuri kryejnë një detyrë jashtëzakonisht të rëndësishme, për të cilën e gjithë shoqëria jonë u është thellësisht mirënjohëse! Të dashur nxënës, Besoni te vetja, besoni tek ëndrrat tuaja dhe tek e ardhmja. Ajo do të jetë më e mirë dhe është në duart tuaja*“, shkruan kreu i shtetit.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Viti i ri shkollor/ Ministrja Kumbaro uron nxënësit: Më shumë kushte bashkëkohore, siguri, dije dhe zbavitje në programin "Pas Shkolle"]

08:10 Sociale

[Akuzat për kushtet e sportistëve të 'EUSA Combat 2026', Gonxhja: Fotot nuk janë nga ambientet ku qëndrojnë delegacionet]

18:10 Sociale

[Ndryshon ligji për legalizimet, kushte për zonat ku parashikohet ndërtimi i pallateve]

13:50 Sociale / 5 komente

[Vjeshta shuan flakët! "Mbrojtja": Asnjë vatër aktive. U fikën zjarre në Dibër, Lezhë, Elbasan...]




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.